

KOMITETI SEKTORIAL NË MIKPRITJE DHE TURIZËM

05.07.2023 /09.00-13.00/ Tiranë, Shqipëri

Organizuesi: AKAFPK dhe BERZH

Takimi: nr. 2

Moderimi: Ejvis Gishti

Qëllimi i takimit: Diskutimi i propozimeve të anëtarëve për profile të reja në fushën e hoteleri-turizmit dhe prezantimi i Metodologjisë së Studimit për Vlerësimin e nevojave (Needs Assessment).

Çështjet:

1. *Mirëseardhja, fjalë hapëse dhe prezantimi i agjendës së aktivitetit*

Znj. Ejvis Gishti, Drejtor i Përgjithshëm i AKAFPK-së, mori fjalën hapëse dhe falenderoi anëtarët që gjetën kohën për të qenë pjesë e takimit duke qenë se, është koha me fluksin më të madh të sezonit turistik. Fakti që janë pjesëmarrës tregon rëndësinë që i ka dhënë çdo anëtar këtij Komiteti.

Fjalën në vijim e mori **z. Rrahman Kasa**, në cilësinë e kryetarit të KS, i cili falenderoi anëtarët për përzgjedhjen si kryetar dhe pjesëmarrjen e tyre në takim, si dhe rëndësinë që i kanë dhënë këtij Komiteti. **Z. Kasa** theksoi se, beson që ky Komitet dhe të gjithë anëtarët do të bëjnë një punë të mirë për realizimin e funksioneve të këtij komiteti, për më shumë njerëz të kualifikuar në mënyrë që, shërbimi në sektorin e turizmit të jetë sa më i mirë duke qenë se, është një nga problematikat më të mëdha që has sot.

2. *Propozim për çeljen e një profili të ri në Hoteleri Turizëm*

Në pjesën e dytë të takimit, **znj. Flutura Vaqarri** mori fjalën për të prezantuar anëtarët me shkollën e Hoteleri - Turizmit, profilet që ofrohen aktualisht dhe nevojën për përmirësimin e vazhdueshëm të ofertës së shkollës profesionale. **Znj. Vaqarri** tha se, nisur nga takimet me biznesin dhe diskutimet me bordin e shkollës është menduar që të ketë një profil të dedikuar për “Pastiçeri”. Deri më tani, ky profil është ofruar bashkë me kuzhinën dhe disa orë pastiçeri janë bërë edhe në profilin e prodhimit të produkteve të brumit. Nisur nga nevoja e tregut është parë e domosdoshme që të ofrohet një profil i gjerë i dedikuar në “Pastiçeri”. Po kështu, në pyetësorët që shkolla zhvillon me ta ndër vite, ky profil është shumë i kërkuar dhe nga nxënësit. Ky profil kërkohet sidomos nga vajzat dhe kjo është në të njëjtën linjë me objektivat e Qeverisë dhe MFE, lidhur me AFP, që synojnë rritjen e numrit të vajzave në arsimin profesional.

Z. Rrahman Kasa pohoi se është një propozim me shumë vend hapja e një profili të tillë duke qenë se aktualisht ka një mungesë të madhe në treg të profesionistëve dhe zakonisht bizneset i marrin nga jashtë profesionistët e kësaj fushe. **Anëtarët votuan në unanimitet të plotë për miratimin e propozimit të znj. Vaqarri dhe hapjen e këtij profili të ri.**

3. Prezantim i studimit mbi “Profesionet dhe aftësitë e reja Profesionale të kërkuara në Sektorin e Turizmit dhe Hotelerisë në Shqipëri” dhe diskutime mbi këtë studim

Në vijim, **z. Gid Shaqiri** mori fjalën për të prezantuar një studim mbi profesionet dhe aftësitë e reja profesionale të kërkuara në turizëm, në Shqipëri. Ky studim është ndërmarrë në kuadër të projektit “Aftësi për punë”, një projekt i Agjencisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim që zbatohet në Shqipëri nga Swisscontact.

Studimi është realizuar në periudhën tetor- nëntor 2022 dhe ka përdorur si instrument intervistat gjysmë të strukturuar dhe intervistat e thelluara. Në studim janë përfshirë 14 hotelet me performancën më të mirë, me organigramë dhe standarde të mirëfillta në hoteleri. Nga studimi rezulton se profesionet më të kërkuara aktualisht janë: **Drejtor i përgjithshëm, Menaxher i mesëm (drejtues departamenti), Receptonist dhe Kamarier.**

Shumica e bizneseve menduan se për pozicionet drejtuese do të donin individë të përgatitur nga arsimi i lartë ose arsimi pas të mesëm profesional (me kohëzgjatje deri në 2 vjet). Bizneset kanë shprehur gatishmërinë për të marrë pjesë në grupet e punës për hartimin e programeve /kurrikulave mësimore për shkollat profesionale. Gjithashtu, hotelet u shprehën të gatshëm të ofrojnë bashkëpunimin e tyre për të ofruar vende praktike, trajnim dhe punësim pas përfundimit të praktikës.

Nga studimi rezultoi se, bizneset shqiptare në turizëm kanë vështirësi në rekrutimin e stafit të kualifikuar sidomos në pozicionet menaxheriale të mesme dhe të përgjithshme. Mendohet se arsimi pas të mesmes është një mundësi shumë e mirë për zhvillimin e individëve të kualifikuar dhe është e domosdoshme që këto oferta të drejtohen nga sektori privat dhe të orientohen drejt kompetencave më praktike të lidhura me vendin e punës.

Pas prezantimit, anëtarët filluan diskutimet mbi vlerën e studimit dhe si mund të përdoret ai për të marrë masa dhe për të ndërhyrë për rregullimin e problematikave të evidentuara.

Z. Gid Shaqiri propozoi hapjen e një profili të ri si “Menaxher i mesëm” që të ofrohet në arsimin e mesëm profesional, në nivelin e V të KSHK-së (1-2 vjet). **Znj. Flutura Vaqarri** deklaroi se, kjo është një nismë e vonuar dhe duhej bërë më përpara.

Në vijim të rezultateve të studimit, **znj. Anisa Subashi** deklaroi se, profili i receptonistit duhet të jetë më i gjerë sesa vetëm hoteli. Ata duhet të përgatiten për të qenë receptonist në restorante dhe vende të tjera në mënyrë që tregu i punësimit të jetë sa më i gjerë.

Z. Fatos Cerenishti ndërhyri duke thënë se, duhej sqaruar si do të kualifikohet “Menaxheri i mesëm”, çfarë kriteri duhet të plotësojë një individ për të qenë “Menaxher i mesëm” dhe si do e kuptojë biznesi vlefshmërinë e diplomave që ata kanë dhe kompetencat që kanë fituar.

Znj. Ejvis Gishti sqaroi anëtarët se ata duhet të marrin fillimisht vendimin lidhur me propozimin për hapjen e një profili të ri në nivelin e V të KSHK për “Menaxher të mesëm” (drejtues

departamenti) dhe më pas AKAFPK fillon punën për ndjekjen e gjithë proceduarave për të bërë të mundur hapjen e profilit.

Znj. Anisa Subashi ngriti problemin se njerëzit që kanë punuar deri tani si “Menaxher të mesëm” në biznese dhe pse s’kanë formimin e duhur shkollor ata kanë eksperiencën e mjaftueshme të punës dhe nuk është e drejtë të dalin nga tregu. Por, **z. Rahman Kasa** theksoi se, “Menaxherët e mesëm” që janë aktualisht të punësuar dhe që kanë fituar eksperiencën e mjaftueshme janë tashmë të kualifikuar dhe nuk dalin nga tregu. Krahas kësaj, turizmi është një sektor shumë dinamik dhe që pritet të ketë shumë më tepër zhvillim në vitet në vijim. Rrjedhimisht, kjo do sjellë nevojën për më shumë “Menaxherë të mesëm” në treg.

Anëtarët votuan për propozimin e z. Shaqiri dhe miratuan në unanimitet hapjen e këtij profili të ri.

4. Prezantimi i Metodologjisë së Studimit për Vlerësimin e nevojave (Needs Assessment) dhe diskutime mbi metodologjinë

Në pjesën tjetër të këtij takimi, fjalën e mori **znj. Linda Rama** e cila tha se, ishte e lumtur që po merrte pjesë në një takim të tillë të Komitetit Sektorial, një strukturë e cila është parë gjithmonë si një mungesë e rëndësishme në Shqipëri dhe që më në fund po vihej në jetë me sukses. Në vijim, **znj. Elena Polo** prezantoi pak stafin dhe eksperiencën e HDPC-së në studimin e nevojave të aftësive. **Znj. Polo** theksoi se bashkëpunimi mes ekspertëve të metodologjisë së studimit dhe profesionistëve që veprojnë në fushën e turizmit është shumë i rëndësishëm dhe thelbësor për të patur një studim serioz të nevojave të aftësive në fushën e turizmit. **Znj. Polo** deklaroi se ekspertët e studimit besojnë se një draft paraprak do të jetë gati nga fundi i vjeshtës dhe draft-i final i studimit do të jetë i aksesueshëm pranverën e vitit të ardhshëm. Për këtë studim do të punohet në tre plane kryesore: *analiza desk* (të dhënat historike, të dhëna të përgjithshme për sektorin e turizmit, shpërndarja gjeografike e ofertës së turizmit etj.), *pyetëtori* dhe *kampionimi*.

Në vijim fjalën e mori **znj. Rama** për të shpjeguar pyetëtorin dhe kampionimin që do të përdoret në studim. **Znj. Rama** tha se ky ushtrim që do të bënin për fushën e turizmit është një eksperiencë e përsëritur shpesh nga ta dhe i shërbejnë orientimit në mënyrën e duhur të politikave apo ndërhyrjeve që duhet të bëhen. Një studim i tillë që i shërben dhe Komitetit Sektorial është bërë edhe për nevojat e aftësive në fushën e TIK, i cili është gati për publikim.

Lidhur me kampionin e studimit në fushën e turizmit, **znj. Rama** tha se metodologjia e përzgjedhjes së kampionit është një metodologji shkencore, në mënyrë që të ketë përfaqësim maksimal të sektorit. Për studimin do të merren si kampion vetëm kompanitë aktive, ku përfshihen hotelet dhe strukturat e ngjashme, akomodime për pushime, hapësirat për kampingje, çadra, restorantet, agjencitë e udhëtimit etj. Në studim nuk do të përfshihen bizneset të cilat nuk kanë të punësuar (pra që kanë vetëm pronarin).

Për studimin është menduar që të ketë tre zona për analizimin e sektorit të turizmit: Bashkia e Tiranës, zonat bregdetare dhe zonat jo bregdetare.

Z. Rrahman Kasa ndërhyri duke thënë se është një ndarje shumë mirë e menduar në këtë formë, vetëm se tek zonat jo bregdetare mund të bëhet një ndarje në dy kategori: zonat malore dhe zonat historike-kulturore pasi kanë tipologji tjetër të zhvillimit të turizmit. **Znj. Rama** shpjegoi se shtimi i kategorive ose nëndarjeve duhet të ketë një arsye të fortë dhe të rëndësishme sepse ndikon në kampionim dhe në rezultatet e studimit më pas. Megjithatë mund të diskutohej një ndarje mes turizmit rural dhe atij urban për zonat jobregdetare. Të dhënat do të klasifikohen sipas tre nëndarjeve: biznese mikro (1-9 punonjës), të vogla (10-49 punonjës), të mesme dhe të mëdha (mbi 50 punonjës). Pyetësi është i ndarë në 4 seksione: *Informacioni i përgjithshëm, Aftësitë dhe kompetencat e stafit ekzistues, Rekrutimi për vendet e lira të punës, Trajnimi dhe synon të marrë informacion të gjerë për të gjithë treguesit që ndikojnë në cilësinë e shërbimit.*

Në përfundim të prezantimit të pyetësorit u dakordësua që draft pyetësi t'iu përcillet të gjithë anëtarëve të Komitetit Sektorial për komente ose propozime që mund të kenë që janë të rëndësishme për tu matur.

5. Diskutim i lirë, tema të ndryshme, propozime nga anëtarët; Propozimi dhe miratimi i programit për mbledhjen e tretë të Komitetit

Në këtë pjesë të takimit, anëtarët diskutuan për rëndësinë e pyetësorit dhe pranuan të shikonin edhe njëherë me vëmendje të gjitha seksionet dhe pyetjet e pyetësorit, në rastin se kishin sugjerime apo shtesa për t'ia rekomanduar grupit të ekspertëve. **Z. Kasa** deklaroi se anëtarët kishin pasur mundësinë të diskutonin gjatë gjithë takimit për çdo pikë të agjendës dhe çdo çështje të shtruar, ndaj kjo pikë e agjendës ishte ezauruar. Në përfundim ai propozoi të mendohej mundësia për krijimin e një regjistri elektronik (platformë online), i dedikuar për turizmin, ku çdo biznes mund të regjistrohet dhe të dërgojë aty të gjitha pozicionet e punës që ka të lira. Gjithashtu, ai tha se shkollat e turizmit në rrethe nuk kanë shumë kërkesa për degët e turizmit. Ndaj është e nevojshme që kurrikulat të jenë sa më të përshtatshme me tregun e punës, në mënyrë që të punësuarit e rinj të zotërojnë aftësitë profesionale të kërkuara nga biznesi.

6. Përcaktimi i detyrave për mbledhjen e ardhshme dhe fjala përmbyllëse

Në pjesën e fundit të këtij takimi u përcaktua se, takimi i radhës i Komitetit Sektorial do të realizohej nga fillimi i tetorit. Në takimin e ardhshëm mund të diskutohet validimi i standardit të profesionit “Kuzhinë-Pastiçeri”, i cili është përgatitur nga grupi i punës. Gjithashtu, mund të diskutohen dhe rezultatet paraprake të studimit për analizën e nevojave në fushën e turizmit në Shqipëri, në rastin se do të jenë gati.

Znj. Esmeralda Shehaj në përfundim deklaroi se, duhej bërë një ndërhyrje që arsimi profesional të bëhet më tërheqës për të rinjtë dhe që të orientohen që herët drejt zgjedhjes së formimit profesional. Ajo propozoi që mbledhjen e ardhshme mund të ftohen në takim përfaqësues të IAL-ve, vendimmarrës, profesionistë të orientimit në karrierë, që të diskutohet mbi mënyrat më të mira të promovimit dhe orientimit, këshillimit të të rinjve drejt shkollave të formimit profesional.

Konkluzione

- Hapjen e një profili të ri në shkollën Hoteleri-Turizëm, që i dedikohet plotësisht dhe gjerësisht **pastiçerisë**.
- Hapjen e një kualifikimi të ri në arsimin pas të mesëm, niveli V i KSHK-së, për **“Menaxher të mesëm”**, me një kohëzgjatje 1-2 vjet.
- Pyetësi i hartuar për studimin e analizës së nevojave në fushën e turizmit në Shqipëri, do të jetë një ndihmesë e madhe për të orientuar Komitetin Sektorial për ndërhyrjet e nevojshme që duhen bërë për përmirësimin e këtij sektori.
- Takimi i radhës do të zhvillohet në tetor, ku do të diskutohen validimi i standardit të profesionit “Kuzhinë-Pastiçeri” dhe rezultatet paraprake të studimit për analizën e nevojave të aftësive në fushën e turizmit në Shqipëri, në rastin se do jenë gati.